

**VENDIM****Nr. 519, datë 30.6.2026**

**PËR DEKLARIMIN “PASURI
KULTURORE E PALUAJTSHME” TË
PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI,
MIRATIMIN E KUFIRIT, ZONIFIKIMIT
DHE TË PLANIT PËR RUAJTJEN,
MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E
TIJ DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 396, DATË 31.3.2005 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “a” e “ç”, të pikës 3, të nenit 9, pika 3, e nenit 62, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin “Pasuri kulturore e paluajtshme” të Parkut Arkeologjik Apoloni, sipas hartës së zonifikimit dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e Parkut Arkeologjik Apoloni, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kudo në vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Amantias, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar, dhe në rregulloren që i bashkëlidhet këtij vendimi, fjalët “... Apoloni/Apolonisë dhe harta që i përket Parkut Arkeologjik “Apoloni” ..., hiqen.

4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për publikimin e hartës së Parkut Arkeologjik Apoloni në Gjeoportalin Kombëtar.

5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, të ndryshuar, dhe me aktet nënligjore, në zbatim të tij.

6. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Njësia e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E PARKUT
ARKEOLOGJIK APOLONI**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi i këtij plani është të përcaktojë rregullat, procedurat dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e Parkut Arkeologjik Apoloni, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Objektivat kryesorë të këtij plani janë:

a) ruajtja, mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave kulturore, arkeologjike dhe peizazhit të Parkut Arkeologjik Apoloni;

b) administrimi i Parkut Arkeologjik Apoloni;

c) përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit të institucioneve, të ngarkuara për ruajtjen, mbrojtjen, miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Parkut Arkeologjik Apoloni me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Hapësira territoriale në mbrojtje përfshin:

a) zonën A, e cila përfshin territorin brenda dhe rreth mureve rrethuese dhe zonat arkeologjike me intensitet të lartë të monumenteve funerale dhe religjioze. Sipas intensitetit dhe rëndësisë, hapësirave territoriale në mbrojtje, sipas hartës bashkëlidhur, dhe përbëhet nga:

i. zona A/1 – qyteti antik i Apolonisë;

ii. zona A/2 – Tempulli i Shtyllasit;

iii. zona A/3 – Nekropoli;

iv. zona A/4 – Nekropoli;

v. zona A/5 – Nekropoli.

b) zonën “B” të Parkut Arkeologjik të Apolonisë, e cila është e shtrirë në një territor shumë të gjerë, në shumë parcela të ndara si pronë private dhe e ndarë në shumë numra pronësie, sipas banorëve të fshatrave Radostinë, Havaleas, Pojan, Kryegjatë, Sop dhe Shtyllas.



4. Hartimi dhe miratimi i instrumenteve të planifikimit territorial të fshatrave në Njësinë Administrative Dermenas dhe Levan të Bashkisë Fier marrin në konsideratë kufijtë e zoonimit të Parkut Arkeologjik Apoloni, si edhe në planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

KREU II RUAJTJA DHE MBROJTJA E PASURISË KULTURORE

SEKSIONI 1 NDËRHYRJET E LEJUARA NË PARKUN ARKEOLOGJIK APOLONI

1. Mirëmbajtja, konservimi dhe restaurimi i strukturave arkeologjike në park kryhen mbi bazën e projekteve të shqyrtuara dhe të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim “KKTKM”).

a) Projektet për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin e strukturave arkeologjike në Parkun Arkeologjik Apoloni hartohen nga njësitë e administrimit dhe të koordinimit të parqeve arkeologjike (në vijim “NJAKPA”), në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (në vijim “IKTK”), Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (në vijim “DRTK”) Vlorë, ose/dhe nga persona fizikë/juridikë, të licencuar “Për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale” dhe miratohen nga KKTKM-ja;

b) Zbatimi i punimeve të mirëmbajtjes dhe konservimit kryhet nga NJAKPA-ja dhe/ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

c) Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen nga institucionet shtetërore të specializuara ose nga subjekte të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Krijimi/ndërtimi ose rikonstruksioni i shtigjeve/itinerareve turistike në park kryhet mbi bazën e projekteve të shqyrtuara dhe të miratuara nga KKTKM-ja, sipas këtyre rregullave:

a) Projektet hartohen nga NJAKPA-ja, në bashkëpunim me IKTK-në, DRTK-në Vlorë ose nga persona fizikë/juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

b) Zbatimi i punimeve kryhet nga NJAKPA-ja ose nga subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

c) Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen nga institucionet shtetërore të specializuara ose nga subjekte të licencuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese dhe i rrjeteve inxhinierike në territorin e parkut kryhet mbi bazën e projekteve të shqyrtuara dhe të miratuara nga KKTKM-ja, ndërsa procedura e mëtejshme e miratimit bëhet në përputhje me ligjin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, sipas këtyre rregullave:

a) Projektet për rikonstruksionin e rrugëve ekzistuese dhe të rrjeteve inxhinierike brenda parkut hartohen nga NJAKPA-ja, IKTK-ja e DRTK-ja, si dhe nga persona fizikë ose juridikë, të licencuar sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, duke garantuar se nuk cenohet integriteti i pasurive kulturore të nëntokës;

b) Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi, në varësi të llojit të projektit, kryhen në përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore dhe/ose legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

4. Rikonstruksioni, rindërtimi ose ritrajtimi i godinave ekzistuese kryhet mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja, sipas këtyre rregullave:

a) Projektet për rikonstruksionin, rindërtimin ose ritrajtimin e godinave brenda parkut hartohen nga persona fizikë ose juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, duke respektuar këto kushte:

i. Të mos ndryshohet gjurma e godinave dhe të mos cenohet pasuria kulturore e nëntokës;

ii. Të ruhen karakteristikat tradicionale të ndërtesave të zonës, elementet origjinale të jashtme e të brendshme, tipologjia, trajtimi arkitektonik dhe teknikat e ndërtimit, në harmoni me peizazhin e parkut;

iii. Çatitë të jenë me katër ujëra, me pjerrësi 25–30 gradë dhe të mbuluara me tjegulla vendi me ngjyrë të kuqe.

b) Zbatimi i punimeve kryhet nga subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;



c) Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

5. Vendosja e konstruksioneve të lehta dhe të përkohshme me strukturë druri, xhami, plastike ose metali, për nevoja funksionale të parkut, si informimi publik dhe shërbimet ndihmëse lejohet mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja që kryhen sipas këtyre rregullave

a) Projektet hartohen nga IKTK-ja dhe/ose nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe miratohen nga KKTKM-ja, duke respektuar këto kushte:

- i. Lartësi maksimale 1 (një) kat;
- ii. Të jenë struktura të çmontueshme;
- iii. Të mos dëmtojnë në asnjë rast nëntokën apo peizazhin dhe të plotësojnë kërkesat e sigurisë dhe aksesueshmërisë.

b) Zbatimi i punimeve kryhet nga subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

c) Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

6. Kryerja e testeve arkeologjike, që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, si sondazhe, hulumtime parandaluese ose të shpëtimit, lejohet sipas vendimeve të KKTKM-së dhe në funksion të ndërhyrjeve, të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, sipas këtyre rregullave:

a) Fillimi i punimeve kryhet pas lidhjes së aktmarrëveshjes ndërmjet IKTK-së, zhvilluesit dhe subjektit të licencuar për veprimtari arkeologjike;

b) Zbatimi i punimeve, monitorimi dhe mbikëqyrja arkeologjike kryhen nga institucionet shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike.

7. Zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore kryhet mbi bazën e projekteve të shqyrtuara dhe të miratuara nga KKTKM-ja, pasi ato janë miratuar fillimisht nga organet teknike, këshillat shkencorë, bordet ose departamentet përgjegjëse të institucioneve të specializuara, që kryejnë kërkime arkeologjike, si dhe me dhënien e opinionit të NJAKPA-së, lidhur me periudhën e kryerjes së kësaj veprimtarie. Projektet kërkimore-shkencore realizohen nga institucionet shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike, të cilat janë përgjegjëse për:

a) marrjen e lejeve përkatëse, në përputhje me të ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, dhe me vendimin nr. 220, datë 7.4.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”;

b) kryerjen e hulumtimeve arkeologjike, në përputhje me vendimin e KKTKM-së, sipas llojit të lejes së dhënë;

c) zbatimin e të gjitha masave të sigurisë për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore, personave dhe mjedisit.

8. NJAKPA-ja ndjek në mënyrë të vazhdueshme procesin e të gjitha ndërhyrjeve, nga faza e hartimit, miratimit të projektit, deri në zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve.

9. NJAKPA-ja ndjek procedurat për marrjen e të gjitha lejeve dhe miratimeve të nevojshme për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse, përfshirë ato që lidhen me ndikimin në mjedis dhe në natyrë.

10. Për të gjitha ndërhyrjet në Parkun Arkeologjik Apoloni, gjatë fazës së zbatimit, realizohet monitorim arkeologjik nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike dhe/ose nga institucione shtetërore të specializuara, si dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet shtetërore të specializuara.

11. Të gjitha ndërhyrjet në Parkun Arkeologjik Apoloni kryhen në përputhje me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, dhe me vendimin nr. 220, datë 7.4.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”, dhe legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura.

12. Aplikimet për lejet e ndërhyrjeve kryhen nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.

SEKSIONI 2

REGJIMI I RUAJTJES DHE PËRDORIMI I TOKËS NË ZONËS “B”

1. Në zonën arkeologjike “B” të parkut, përveç ndërhyrjeve të lejuara me kushte dhe kriteret e



parashikuara në seksionin 1, të kreut II, lejohen edhe:

- a) punimi i tokës për qëllime bujqësore;
- b) kultivimi i drithërave dhe perimeve;
- c) kullota.

2. Çdo ndërhyrje në terren, që lidhet me punime bujqësore në thellësi, realizohet vetëm pas informimit dhe në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore dhe NJAKPA-në dhe përfshin:

- a) hapjen e kanaleve vaditëse dhe kulluese;
- b) hapjen e puseve;
- c) rregullimin e rrugëve bujqësore;
- ç) mbjelljen e pemëve.

3. Në rast të mbjelljes së pemëve, subjektet përkatëse janë të detyruara të informojnë NJAKPA-në, me qëllim monitorimin dhe kontrollin e hapjes së gropave.

4. Në zonën arkeologjike “B” ndalohet:

- a) prerja e pemëve;
- b) hedhja dhe depozitimi i mbeturinave;
- c) çdo veprim që sjell tjetërsimin e territorit dhe të peizazhit kulturor.

SEKSIONI 3 NDËRHYRJE TË TJERA NË PARKUN ARKEOLOGJIK

1. Ndërhyrje të paautorizuara në parkun arkeologjik konsiderohen të gjitha ndërhyrjet mbi pasuritë kulturore të paluajtshme ose të luajtshme, të kryera pa miratimin paraprak të KKTKM-së, sipas këtyre rregullave:

a) Në rast konstatimi të ndërhyrjeve të paautorizuara brenda parkut, NJAKPA-ja ka detyrimin:

i. të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit, me akt konstatimi;

ii. të njoftojë menjëherë IKTK-në, institucionin kompetent të njësisë së vetëqeverisjes vendore për inspektimin e mbrojtjes së territorit, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. Gjetjet rastësore brenda territorit të parkut mund të evidentohen kryesisht gjatë zbatimit të punimeve të miratuara për rikonstrukcion, rindërtim ose ritrajtim të godinave ekzistuese, pavarësisht pronësisë, gjatë rikonstrukcionit të rrugëve dhe rrjeteve inxhinierike, si dhe gjatë punimit të tokës apo veprimtarive të tjera të banorëve, në përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore.

3. Në varësi të vlerave dhe rëndësisë shkencore të gjetjeve rastësore arkeologjike, KKTKM-ja përcakton procedurat dhe hulumtimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.

4. Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese në territorin e Parkut, pranë monumenteve, rrënojave ose hapësirave me potencial arkeologjik, kryhet pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja, sipas këtyre rregullave:

a) Në asnjë rast, tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo të cenojnë pamjen, peizazhin dhe integritetin e monumenteve, dëshmive dhe gjetjeve arkeologjike;

b) Vendosja e tabelave prezantuese dhe e sinjalistikës rrugore/turistike në afërsi të parkut arkeologjik, që ofron informacion për parkun dhe vlerat kulturore të tij, kryhet nën mbikëqyrjen e NJAKPA-së ose subjektit të ngarkuar me administrimin, pas njoftimit zyrtar të njësisë së qeverisjes vendore.

KREU III RUAJTJA FIZIKE E PASURISË KULTURORE

1. NJAKPA-ja garanton sigurinë dhe ruajtjen fizike të pasurisë kulturore, përfshirë mbrojtjen nga rreziku i zjarrit.

2. NJAKPA-ja monitoron dhe kontrollon vazhdimisht faktorët e riskut që mund të cenojnë sigurinë dhe integritetin fizik të pasurisë kulturore.

3. Për parandalimin dhe shuarjen e zjarrit, NJAKPA-ja merr masa për:

a) pajisjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe sistemeve të zbulimit, sinjalizimit dhe shuarjes së zjarrit;

b) zbatimin e procedurave të emergjencës sipas legjislacionit në fuqi.

4. Në kuadër të detyrimit për ruajtjen fizike të pasurisë kulturore, NJAKPA-ja lidh protokolle bashkëpunimi me:

a) Policinë e Shtetit;

b) autoritetin kompetent për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, jo më vonë se data e transferimit të administrimit.

5. Për sigurimin fizik të parkut, NJAKPA-ja angazhon subjekte të licencuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kriteret e mbrojtjes së pasurive kulturore.



KREU IV INVENTARI DHE KARTELAT E PASURISË KULTURORE

1. NJAKPA-ja mban dhe përditëson periodikisht inventarin dhe kartelën e pasurisë kulturore, në përputhje me formatin dhe të dhënat e miratuar nga IKRTK-ja dhe IKTK-ja.

2. Çdo ndërhyrje e kryer në pasuritë kulturore, si dhe çdo rast qarkullimi i pasurive të luajtshme, pasqyrohet në inventar dhe në kartelën përkatëse.

3. NJAKPA-ja, në mënyrë sistematike ose sipas nevojës, kryen verifikimin e gjendjes së ruajtjes të pasurive kulturore, duke kërkuar asistencë nga IKTK-ja, kur është e nevojshme.

4. NJAKPA-ja mban kontakt dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me IKRTK-në dhe IKTK-në për çështjet që lidhen me inventarin dhe kartelat e pasurive kulturore.

KREU V RAPORTIMI DHE MONITORIMI

1. NJAKPA-ja Apoloni dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore deri në datën 30 janar të vitit pasardhës raportin vjetor për administrimin e pasurisë kulturore gjatë vitit kalendarik paraardhës.

2. Raporti duhet të përmbajë këto elemente kryesore:

- a) Gjendjen e konservimit të pasurisë;
- b) Nivelin e realizimit të planeve vjetore të veprimtarive kulturore;
- c) Të dhëna për numrin e vizitorëve dhe listën e shërbimeve të ofruara;
- ç) Informacion për personelin (numri i punonjësve) dhe kontraktorët e angazhuar (me kopje kontratash);
- d) Raportimin për të ardhurat totale vjetore të gjeneruara;
- dh) Shkallën e realizimit të objektivave, të përcaktuar në planin vjetor.

2. Struktura përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në ministri, mbi bazën e raportimit vjetor, vlerëson dhe analizon administrimin e pasurisë kulturore nga NJAKPA-ja Apoloni dhe, sipas rastit, i propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore marrjen e masave konkrete.

KREU VI DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Për të gjitha çështjet, që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet NJAKPA-së/subjektit administrues dhe institucioneve të specializuara.

X	Y
454864.7212	4508993.555
454858.3789	4508923.866
454842.4848	4508834.385
454837.5943	4508830.029
454827.6605	4508822.923
454819.7898	4508817.192
454812.2249	4508814.441
454804.5835	4508815.434
454795.7959	4508821.165
454791.2874	4508833.621
454788.2309	4508850.661
454783.5696	4508872.134
454780.0546	4508894.599
454775.3169	4508907.59
454772.566	4508922.414
454773.6358	4508938.766
454777.6093	4508959.551



454775.7754	4508993.632
454770.2736	4509014.875
454759.8813	4509040.091
454740.7778	4509082.73
454736.6515	4509100.611
454731.6082	4509140.499
454725.8007	4509195.823
454717.7008	4509228.222
454680.1052	4509298.523
454672.7694	4509366.379
454691.2616	4509586.145
454703.4878	4509738.667
454716.631	4509794.908
454743.2231	4509901.276
454758.9643	4509984.262
454766.6057	4510035.306
454791.3638	4510052.729
454839.3518	4510072.596
454858.7609	4510088.643
454891.6189	4510136.173
454951.8331	4510222.062
455042.6128	4510348.756
455085.099	4510413.25
455109.3222	4510466.052
455124.4522	4510509.226
455134.0803	4510550.183
455147.3763	4510559.964
455160.3667	4510557.978
455195.3643	4510527.259
455217.6772	4510525.884
455263.2199	4510574.33
455441.952	4510487.906
455471.295	4510528.1
455545.2637	4510585.869
455636.9604	4510466.052
455728.9627	4510361.365
455735.6872	4510293.509
455747.3021	4510266
455760.4453	4510233.295
455776.3394	4510198.144
455772.9772	4510166.051
455681.2805	4510063.045
455717.6535	4510037.064



455699.0085	4510013.528
455693.8123	4509949.494
455681.4333	4509921.985
455684.4898	4509877.664
455688.9218	4509863.604
455715.0554	4509862.687
455723.9194	4509871.093
455744.8568	4509885.459
455759.5283	4509890.196
455758.917	4509862.687
455665.0807	4509707.109
455648.2696	4509689.381
455581.0254	4509623.665
455550.6126	4509587.139
455509.0435	4509535.024
455499.5681	4509532.885
455450.2047	4509547.556
455434.3106	4509549.39
455425.4466	4509542.36
455398.5489	4509450.511
455338.7932	4509471.754
455329.3943	4509468.926
455294.8552	4509431.331
455294.5496	4509405.656
455301.4268	4509383.037
455299.4401	4509367.296
455284.1573	4509343.607
455238.9202	4509305.859
455207.4377	4509277.739
455157.0045	4509203.77
455129.8011	4509179.47
455093.5809	4509148.599
455059.9588	4509129.725
455036.8054	4509122.236
455022.1339	4509111.844
454984.8439	4509078.528
454964.6706	4509045.211
454932.5768	4509027.177
454925.2411	4509015.868
454898.3433	4508994.167
454864.7212	4508993.555



Nr.	X	Y
1	455161.0544	4508327.073
2	455138.5887	4508351.296
3	455109.7807	4508342.814
4	455049.9486	4508294.444
5	455031.2654	4508264.566
6	454963.1042	4508233.924
7	454935.9008	4508298.876
8	455025.3433	4508339.911
9	455079.75	4508371.24
10	455103.6294	4508349.233
11	455133.8129	4508359.473
12	455118.5301	4508389.274
13	455235.1377	4508397.832
14	455247.2111	4508356.798
15	455242.0914	4508349.462
16	455205.0306	4508334.027

Zona A3 – Reparti ushtarak

Nr.	E	N
1	456534.4502	4509710.53
2	456662.478	4509473.421
3	456708.4367	4509409.482
4	456718.91	4509366.86
5	456774.75	4509296.46
6	456728.063	4509253.92
7	456670.83	4509284.594
8	456649.8553	4509319.911
9	456659.905	4509342.646
10	456639.852	4509346.109
11	456574.68	4509371.579
12	456498.1549	4509420.592
13	456402.8778	4509456.314
14	456348.4165	4509461.361
15	456260.922	4509484.918
16	456177.664	4509467.832
17	456131.833	4509470.932
18	456127.213	4509518.547
19	456140.23	4509557.19
20	456240.339	4509662.121
21	456353.882	4509659.689
22	456405.46	4509664.41
23	456463.398	4509677.919



Nr.	X	Y
1	456231.9351	4510046.334
2	456207.4602	4510020.47
3	456206.6881	4510008.58
4	456273.5115	4509917.011
5	456192.5205	4509829.071
6	456167.3121	4509754.913
7	456184.6839	4509734.724
8	456203.87	4509735.187
9	456272.1989	4509757.963
10	456438.1186	4509761.978
11	456530.9224	4509775.953
12	456571.2249	4509791.162
13	456650.0541	4509834.476
14	456838.75	4509907.515
15	456873.8024	4509962.718
16	456908.5459	4509965.189
17	457006.9087	4509940.868
18	457123.3381	4509930.214
19	457169.6628	4509913.537
20	457208.1123	4509904.581
21	457205.7961	4509918.478
22	457204.5607	4509928.361
23	457188.9648	4509947.199
24	457181.0896	4509956.464
25	457147.6586	4509976.365
26	457117.4124	4510008.001
27	457088.9227	4510067.528
28	457058.9661	4510097.793
29	457018.5864	4510084.514
30	457019.4357	4510043.285
31	456999.7477	4510011.321
32	456974.4235	4510001.824
33	456950.4891	4509973.875
34	456931.0327	4509970.4
35	456886.1749	4509971.636
36	456871.7371	4509990.32
37	456762.0247	4510197.469
38	456583.5202	4510123.272
39	456542.0596	4510118.331
40	456479.3669	4510089.532
41	456413.663	4510081.657
42	456354.213	4510065.945



43	456310.1659	4510046.45
44	456265.7714	4510047.994
45	456231.9351	4510046.334

	N	E
1	4509472.036	457103.892
2	4509493.148	457123.553
3	4509507.309	457170.9853
4	4509506.039	457203.3373
5	4509518.658	457218.067
6	4509523.315	457236.2581
7	4509498.077	457283.2812
8	4509430.754	457345.673
9	4509415.231	457337.5566
10	4509398.498	457322.0117
11	4509385.002	457314.559
12	4509373.888	457302.955
13	4509366.452	457293.118
14	4509373.393	457280.1256
15	4509406.215	457266.244
16	4509413.059	457256.403
17	4509419.074	457218.218
18	4509408.797	457195.853
19	4509419.352	457155.602
20	4509444.153	457120.248

Nr.	X	Y
1	453690.8081	4510044.399
2	453613.9091	4509840.107
3	453720.1085	4509675.886
4	453774.4821	4509591.807
5	453921.3314	4509336.79
6	453930.5963	4509319.418
7	453980.8586	4509265.218
8	453887.9776	4509179.517
9	453975.9945	4508667.166
10	454307.6215	4508561.719
11	454612.9013	4508459.342
12	454622.1662	4508447.297
13	454787.0821	4508460.963
14	454780.1334	4508399.699
15	454774.1112	4508342.256
16	454776.4274	4508293.615



17	454795.8838	4508226.213
18	454873.9409	4508218.801
19	454942.0382	4508216.485
20	454977.7083	4508224.823
21	455029.1287	4508244.743
22	455057.85	4508275.78
23	455102.785	4508288.288
24	455163.0071	4508288.288
25	455234.8104	4508310.06
26	455367.9939	4508407.806
27	455408.528	4508454.13
28	455482.4159	4508458.299
29	455567.4217	4508481.925
30	455638.0669	4508521.764
31	455712.8813	4508579.207
32	455780.747	4508651.937
33	455808.5418	4508625.995
34	455828.2298	4508629.006
35	455931.9971	4508665.139
36	456066.3387	4508735.553
37	456107.1045	4508754.083
38	456158.0616	4508760.105
39	456210.8718	4508778.635
40	456264.1452	4508820.327
41	456335.022	4508850.901
42	456369.5339	4508874.064
43	456444.1167	4508869.663
44	456493.2208	4508883.56
45	456570.5831	4508965.092
46	456608.5693	4508991.034
47	456766.5366	4509089.705
48	456939.791	4509088.084
49	457034.0617	4509135.335
50	457107.2547	4509166.836
51	457179.5213	4509205.749
52	457217.5075	4509216.403
53	457242.0596	4509222.425
54	457287.9211	4509222.889
55	457299.5023	4509226.595
56	457357.4081	4509315.538
57	457372.6953	4509370.201
58	457372.232	4509387.805
59	457412.9978	4509420.695



60	457467.1977	4509593.486
61	457485.2643	4509855.221
62	457564.9428	4509915.906
63	457604.782	4509999.291
64	457666.8571	4510121.588
65	457755.3373	4510207.289
66	457835.479	4510256.393
67	457880.414	4510283.261
68	457938.7831	4510299.011
69	457976.3061	4510305.96
70	458015.2189	4510346.263
71	458002.1901	4510351.822
72	457919.9637	4510358.77
73	457848.6237	4510384.017
74	457753.658	4510399.999
75	457681.1599	4510420.614
76	457685.3291	4510493.575
77	457630.4343	4510552.871
78	457638.3095	4510673.778
79	457571.1387	4510718.713
80	457532.6892	4510736.317
81	457507.4423	4510741.644
82	457478.4893	4510749.982
83	457436.1022	4510775.924
84	457410.1604	4510789.358
85	457370.0895	4510794.222
86	457357.5818	4510802.793
87	457421.5099	4510861.625
88	457453.474	4510886.409
89	457474.0885	4510913.277
90	457498.6406	4510955.432
91	457513.6961	4511002.22
92	457524.5824	4511042.523
93	457523.4243	4511061.516
94	457477.3312	4511042.291
95	457449.0731	4511023.53
96	457430.7749	4511017.044
97	457419.6569	4511036.269
98	457406.2228	4511078.656
99	457392.7886	4511095.565
100	457374.0271	4511099.039
101	457333.9563	4511086.068
102	457319.364	4511068.001



103	457310.7939	4511069.16
104	457294.5803	4511077.498
105	457265.1641	4511079.814
106	457232.9684	4511071.244
107	457213.512	4511062.211
108	457206.1001	4511059.431
109	457176.9155	4511066.612
110	457157.4591	4511069.623
111	457131.7489	4511061.516
112	457109.9763	4511052.019
113	457085.8875	4511048.545
114	457068.0525	4511050.861
115	457044.8901	4511063.601
116	456984.4364	4511108.072
117	456974.9398	4511120.348
118	456956.6416	4511155.092
119	456949.9245	4511159.493
120	456939.9647	4511158.103
121	456912.8647	4511150.923
122	456904.063	4511148.375
123	456888.5443	4511158.798
124	456888.081	4511182.655
125	456879.2793	4511194.005
126	456854.264	4511201.648
127	456820.2153	4511208.134
128	456801.6854	4511210.218
129	456786.0509	4511206.512
130	456770.6479	4511201.185
131	456753.0445	4511204.775
132	456742.7373	4511211.955
133	456731.0403	4511219.252
134	456717.3745	4511218.325
135	456695.7177	4511211.261
136	456682.0519	4511207.555
137	456665.0276	4511221.915
138	456644.4131	4511241.835
139	456625.6516	4511255.501
140	456592.0662	4511258.049
141	456549.2158	4511258.28
142	456501.2698	4511263.376
143	456422.981	4511297.193
144	456347.4718	4511325.219
145	456310.1804	4511330.547



146	456245.0942	4511303.91
147	456179.7763	4511265.461
148	456091.2962	4511256.196
149	456042.6552	4511291.866
150	455946.2998	4511287.696
151	455871.7171	4511326.146
152	455841.1428	4511334.021
153	455748.9566	4511334.484
154	455609.056	4511168.642
155	455571.533	4511129.266
156	455549.7604	4511094.522
157	455536.0946	4511035.227
158	455500.8879	4510942.114
159	455415.6504	4510806.383
160	455357.2813	4510723.462
161	455178.4679	4510586.804
162	455128.9005	4510551.134
163	455114.5399	4510522.412
164	455096.4732	4510474.698
165	454971.2807	4510581.129
166	454839.3711	4510425.71
167	454660.5578	4510500.987
168	454787.2558	4510759.942
169	454451.4018	4511047.155
170	453511.4736	4510267.511
171	453690.8081	4510044.399

